

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - MUNICIPALITY OF SUHAREKE REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY OF SUHAREKE			
16 03 2020			
RECEIVED			
Nr. Org. Org. Jachica Org. nr.	Nr. tit. Nr. Number	Nr. Org. Nr. Org. Appenete	Vlera Vrednost Value
03	351	16043	L



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË
KONTRATË**

KOMUNA SUHAREKË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), te cilën e përfaqëson B Mustafë Buzhala zyrtar i Zyres se prokurimit dhe menaxheri i kontratës i/e caktuar me Aktvendim nga ZKA dhe në PMK nga njësia e kërkesës, në njërën anë dhe:

Vector Pest Control SH.P.K. Gelanc, 23 000, Suhakrek NUI 810186652 të cilën e përfaqëson Arber Delijaj, në anën tjetër janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Titulli i kontratës

**Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi në zonat endemike në Komunen e Suharekës
Nr.prokurimit: 624-20-846-2-3-5/624- 020 -012- 235**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Shërbimet e Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi në zonat endemike në Komunen e Suharekës, sipas specifikimit të detyrueshme të dhëna me dosje të tenderit me kuotim të çmimeve.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 13/03/2020 dhe përfundon pas pese (5) dite pune, siq është parapare me dosje të tenderit.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 1 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimit është në teritorin e Komunës së Suharekës sipas specifikimeve teknike të detyrueshme të aneksit 1 të dhënë me dosje të tenderit.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 9.482,60 € (Nente mijë e katerqind e tetedhjet e dy euro e gjashtedhjet cente)

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro nga njësia e kërkesës. **Autoriteti Kontraktues do të lejoj pagesat, ku operatori ekonomik duhet të sjellë faturën për kryerje të shërbimeve dhe raportin e nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës nga njësia e kërkesës në llogarin bakare të OE.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 10 ditë, pas pranimit të *shërbimeve*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *shërbimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **gjykatën kompetente** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi



14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.


E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.


Kontakt numri i Operatorit ekonomik 049-300-199 Email : info@vectorpest-ks.com

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Arber Delijaj	Emri:	Mustafë Buzhala
Pozita:	Përfaqësues	Pozita:	Zyrtar i zyres së prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	13/03/2020	Data:	13/03/2020
Vula:	VV	Vula:	VV





KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVAREKE / MUNICIPALITY OF SUHAREKE
Drejtoria e Shendetesise dhe Mireqenjes Sociale

1.Paramasat per Sherbimet e Dezinfektimit ,ne Komune te Suharekes

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	m2	Totali m2	Qmimi per m2	SHUMA
2	Dezinfektimi, 1 Objektit të Komunes	m2	1	1670	1670	0.34 €	567.80 €
3	Dezinfektimi, 1 Objektit të Asamblese	m2	1	870	870	0.34 €	295.80 €
4	Dezinfektimi, 1 Objektit të Biblotekës	m2	1	1540	1540	0.34 €	523.60 €
5	Dezinfektimi, 1 Objektit të QPS	m2	1	170	170	0.34 €	57.80 €
6	Dezinfektimi, 1 Objektit të Kadastra	m2	1	630	630	0.34 €	214.20 €
8	Dezinfektimi, 1 Objektit të Gjendja Civile	m2	1	528	528	0.34 €	179.52 €
9	Dezinfektimi, 1 Objektit të QKMF dhe Emergjencia	m2	1	1705	1705	0.34 €	579.70 €
	Dezinfektimi, 1 Objektit të QMF dhe	m2	6	190	1140	0.34 €	387.60 €
	Dezinfektimi, 1 Objektit të AMF dhe	m2	11	130	1430	0.34 €	486.20 €
	Dezinfektimi, 1 Stacionit te Autobusave	m2	1	80	80	0.34 €	27.20 €
	Dezinfektimi, 1 Stacionit te Policise Suhareke	m2	1	1046	1046	0.34 €	355.64 €
	Dezinfektimi, 1 Stacionit te Policise Mushisht	m2	1	281	281	0.34 €	95.54 €
	Dezinfektimi, 1 Qendes per Prodhimin e Dokumenteve	m2	1	800	800	0.34 €	272.00 €

4,042.60 €

2.Realizimi i procesit të D.D.D. në ambientet e mbrendshme të shkollave fillore dhe të mesme

Pershkrimi i gnumit .	Pershkrimi I CMIMT					SHUMA
	Njesia	Sasia	m3	Totali m3	Qmimi per m3	

